



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimno / Podato Received / Delivery	10 . 01 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shitujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SDM/SHK	108 / 2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1037/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Rusht Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1037/2022 të datës 22.11.2022, të parashtruar nga ankuesja

kundër Njoftimit të datës 28.10.20122 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 05.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.1037/2022 e datës 22.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Mitrovicës në pozitën "Zyrtare Administrative", më datë 04.10.2022 ka parashtruar kërkesë në Komunën e Mitrovicës Jugore për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së vjehrrës. Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës përmes njoftimit të datës 28.10.2022 ka njoftuar ankuesen që bazuar në dispozitat ligjore në fuqi vjehrra nuk është anëtare e ngushtë e familjes dhe nuk mund të lejohet pagesa e pagës mesatare. Ankuesja përsëri ka bërë ankesë tek Komisioni për Ankesa me pretendimin e njëjtë për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së vjehrrës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës së Jugut përmes përgjigjes në ankesë të datës 17.11.2022 e ka njoftuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për Shërbimin Publik është i obliguar ti shqyrtoj vetëm ankesat për Nëpunësit e Shërbimit Publik.



Ankuesja, e pakënaqur me përgjigjen e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës së Jugut të datës 17.11.2022 si dhe me njoftimin e datës 28.10.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës përmes postës më datë 18.11.2022 ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është protokolluar me Nr.Prot:7308/2022 me datë 22.11.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.12.2022 ankesën e ankueses e ka dërguar tek Komuna e Mitrovicës së Jugut për përgjigje në ankesë. Ndërsa më datë 09.12.2022 me numër protokoll 7854/2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Mitrovicës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. Protokoll 7308/2022 të datës 22.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 17.11.2022; Ankesë e ankueses drejtuar Komisionit për ankesa e datës 02.11.2022; Flete dorëzim i datës 28.10.2022; Njoftim i Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës i datës 28.10.2022; Kërkesë për pagesë në vlerë prej një (1) page me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes i datës 04.10.2022; Certifikatë e vdekjes me numër V10535754 i datës 04.10.2022; Certifikatë e vdekjes me numër V10030709 i datës 27.01.2016; Vërtetim nga arkivi për A.M. me numër A10048763 i datës 22.11.2016; Deklaratë e bashkësisë familjare me numër F10621063 i datës 24.10.2018; Pliko me numër R2433444 i datës 18.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.12.2022; Përgjigje në ankesë përmes emailit me numër protokoll 7854/2022 i datës 09.12.2022; Akt Emërim i A.M. i datës 27.02.2013; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 29.09.2012; Flete dorëzim i datës 17.11.2022;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në pretendimet ankimore të ankueses për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së vjehrrës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet e ankueses janë në kundërshtim me Ligji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht neni 271 ku përcaktohet se: *“Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”.*

Prandaj në kohën e parashtrimit të kërkesës dhe ankesës në KPMSHCK, ankuesja ka ofruar dëshmi certifikatën e vdekjes me nr. V 10535754 të datës 04.10.2022, me të cilën dëshmohet se vjehrra Besa Maxhuni ka vdekur më datë 13.09.2022, ndërsa ankuesja ka ofruar si provë se ka jetuar me të ndjerën certifikatën e bashkësisë familjare F10621063 të datës 24.11.2018, mirëpo ankuesja nuk ka ofruar dëshmi se në kohën e vdekjes së të ndjerës Besa Maxhuni e njëjta ka pasur bashkësi familjare.



Andaj nisur nga këto fakte, Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka ofruar fakte relevante sa i përket bashkësisë familjare të përkufizuar sipas Ligjit nr.2004/32 për Familjen në Republikën e Kosovës, në momentin e vdekjes së të ndjerës (vjehtës), kështu që në mungesë të kësaj Kolegji konstaton se është i pa bazuar pretendimi i ankueses.

Kolegji pasi ka shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet relevante dhe ka konstatuar gjendjen faktike dhe juridike ka vendosur për refuzimin e ankesës së ankueses për shkak të mungesës së provave (mungesës së certifikatës për bashkësinë familjare).

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.1037/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së